

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA KOMBETARE E NOTERISE  
DEGA VENDORE DURRES

Nr. Rep. 109  
Nr. Kol. 51/1



## KONTRATE DHURIMI

*"kuota"*

Ne Durres, sot me date **07 Shkurt 2020 ( dymije e njezet )**, para meje Noteres Melpomeni Nika, antare e Dhomes Kombetare te Noterise, Dega Vendore Durres, me Studio Noteriale Lagje 4 Rruga Skenderbej, u paraqiten personalisht :

### PALA DHURUESE

**SPIRO NINI**, me atesi Foto, i dtl. 25/04/1935, lindur ne Kudhes Vlore dhe banues ne Durres Lagje 1 Rruga Taulantia, shtetas shqiptar, me gjendje civile i martuar, identifikuar me Karte Identiteti nr. personal D50425057G me date leshimi 11/05/2012, **ortak i Shoqerise "ARVI" Shpk**, rregjistruar si person juridik ne QKB me NUIS J61821503Q

### PRANUESI DHURIMIT

**VIRGJIL NINI**, me atesi Spiro, i dtl. 25/11/1960, lindur ne Durres dhe banues ne Durres Lagje 1 Rruga Taulantia, shtetas shqiptar, me gjendje civile i martuar, identifikuar me Karte Identiteti nr.personal G01125052D me date leshimi 16/10/2019, **ortak i Shoqerise "ARVI" Shpk**, rregjistruar si person juridik ne QKB me NUIS J61821503Q

*madhore dhe me zotesi te plote per te vepruar, me vullnet te lire kerkuan perpilimin e kesaj kontrate dhurimi kuotash, dhe deklarojne :*

*(Signature of Spiro Nini)*

*(Signature of Virgjil Nini)*

Z. Spiro Nini se bashku me Virgjil Nini dhe Arian Kushta jane ortak te shoqerise " Arvi " Shpk duke zoteruar Spiro Nini - 25 % pjese te kapitalit ( kuotave), Virgjil Nini – 25% pjese te kapitalit ( kuotave) dhe Arian Kushta – 50 % pjese te kapitalit ( kuotave) te Shoqerise " Arvi " Shpk .

### OBJEKTI

Pala dhuruese, duke u bazuar ne nenin 9 te Statutit te Shoqerise "Arvi " Shpk , ne te cilen citohet se *"pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ndermejt ortakeve , ne rruge trashegimie, ne rast ndarjesh pasurore ndermjet bashkeshorteve dhe ndermejt paraardhesve dhe pasardhesve "* z.Spiro Nini, te gjithë pjesen e kapitalit ( kuotave) te zoteruara nga ana e tij ne kete shoqeri e barabarte me 25 % ia dhuron djalit te tij z. Virgjil Nini se bashku me te gjithë te drejtat dhe detyrimet e kesaj Shoqerie.

### KUSHTET E DHURIMIT

Pranuesi dhurimit , z. Virgjil Nini deklaroi se ka njohuri te plota per dhurimin e 25 % pjese te kuotave te Shoqerise "Arvi" Shpk Durres nga z. Spiro Nini, pranon kete dhurim se bashku me te gjitha te drejtat dhe detyrimet e Shoqerise dhe felenderon babain e tij per dhurimin.

Pranuesi dhurimit , z. Virgjil Nini pas nenshkrimit te kesaj kontrate, behet pergjegjes per te gjitha detyrimet ligjore ndaj shtetit qe mund te lindin ne lidhje me rregjistrimin e kesaj pasurie qe nga momenti i firmosjes se kesaj kontrate.

Pas nenshkrimit te kesaj kontrate nga palet kontraktuese , pronesia e 25 % pjese te kapitalit te Shoqerise " Arvi " Shpk Durres transferohet nga z. Spiro Nini tek Virgjil Nini ne perputhje me objektin e kesaj kontrate.

### TE DREJTAT E PRANUESIT DHURIMIT

Z. Virgjil Nini fiton te drejten e pronesise mbi 25 % pjese te kuotave te Shoqerise "Arvi" Shpk me nenshkrimin e kesaj kontrate dhe me depozitimim e kesaj kontrate prane QKB.

### TE DREJTAT DHE DETYRIMIT E DHURUESIT

Pala dhuruese e garanton pranuesin e dhurimit per pronesine e plote dhe te ligjshme te tij mbi 25 % te kapitalit ne shoqerine "Arvi" Shpk .

Pales dhuruese, z. Spiro Nini me dhurimin e 25 % pjese te kuotave te Shoqerise "Arvi" Shpk i pushojne te gjitha te drejtat dhe detyrimet si ortak ndaj shoqerise dhe pranuesi dhurimit Virgjil Nini do te vazhdoje te jete bashkepronar me Arian Kushta ne Shoqerine "ARVI " Shpk ne raportet e percaktuara si me poshte :

- o **Z. Virgjil Nini** - ortak i shoqerise ne **50 % pjese te kapitalit** ( kuotave)
- o **Z. Arian Kushta** - ortake i shoqerise ne **50 % pjese te kapitalit** ( kuotave)

Ne baze te certifikates familjare date 05/02/2020, z. Spiro Nini rezulton i martuar me zj. Mari Nini , me atesi Neço, e dtl. 15/10/1934, lindur ne Kudhes Vlore dhe banuese ne Durres Lagje 1 Rruga Taulantia, shtetase shqiptare, me gjendje civile e martuar, identifikuar me Karte Identiteti nr. personal D46015076H me date leshimi 11/05/2012 , e cila ne baze te nenit 231 Kodit Civil, nenit 74 e 76 te Kodit Familjes , deklaroi se jep pelqimin dhe miraton dhurimin e 25% pjese te kapitalit ( kuotave) qe bashkeshorti i saj Spiro Nini zoteron ne Shoqerine « Arvi » shpk ne favor te djalit te saj Virgjil Nini .

Per efekt te zbatimit te nenit 764 , paragrafi 3 te Kodit Civil, saktosohet se vlere e 25% , pjese e kapitalit ( kuotave) qe zoteron dhuruesi Spiro Nini ne Shoqerine Arvi Shpk dhe sipas ketij akti noterial i dhurohen Virgjil Nini, eshte 21.433.500 ( njezet e njemiljon e katerqind e tridhjet e tremije e pesqind ) Lek.

Meqense z. Spiro Nini dhe bashkeshortia e tij Mari Nini jane te moshuar dhe nuk mund te paraqiten ne zyren time noteriale une noteria ne oren 11.30 , u paraqita ne banesen e tyre ne Durres Lagje 1 Rruga Taulantia, ne pallatin qe ndodhet tek Hotel Arvi shpk , te cilet u njohen me permbajtjen e aktit noterial, e lexuan dhe me deklaruan se e kuptojne permbajtjen e ketij akti ne te eshte shprehur vullneti i tyre i lire dhe e nenshkruajn para meje noteres. Kontrata Dhurimit u hartua ne kater origjinale, nga te cilat nje origjinal mbahet prane kesaj zyre i depozituar ne arshiven noteriale, bashkalidhur me dokumentacionin perkates, ne te cilen aplikohet tarifa e pulles dhe kopjet e tjera origjinale u jepen paleve kontraktuese. Une Noteria duke u bazuar ne Ligjin " Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare "si dhe ne Ligjin Nr.110 date 20.12.2018 "Per Noterine" e vertetoj.....

**PALA DHURUESE**

*Spiro Nini*

*Mari Nini*

Miraton aktin e dhurimit - bashkeshortia

*Mari Nini*

**PRANUESI DHURIMIT**

*Virgjil Nini*

**NOTERE**  
Melpomeni Nika

*Melpomeni Nika*




**REZULTATET E KËRKIMIT**

Numri i Rezultatit të Kërkimit: D-20200206132019150  
Data e Rezultatit të Kërkimit: 06.02.2020  
Ora e Rezultatit të Kërkimit: 1:20:19PM  
Lloji i Kërkimit:  
Numri i Dokumentit: D-400-211-756  
Referenca e Përdoruesit:

**LISTA E PERSONAVE ME REZULTAT KËRKIMI 0**

ARVI SH.P.K.



*Arvid Jaku*